

Pyetësor

1. Nëse tensioni i zbatuar në një qark rritet, ndërkohë që rezistenca mbetet konstante, çfarë ndodh me rrymën?
 - Zvogëlohet.
 - Rritet.
 - Mbetet në të njëjtën vlerë.
 - Vlerat e tensionit dhe rezistencës nuk janë të mjaftueshme për të dhënë një përgjigje.
2. Nëse në një qark tensioni mbetet konstant, por rezistenca rritet, çfarë ndodh me rrymën?
 - Zvogëlohet.
 - Rritet.
 - Mbetet në të njëjtën vlerë.
 - Vlerat e tensionit dhe rezistencës nuk janë të mjaftueshme për të dhënë një përgjigje.
3. Pse një llambë fluoreshente 60 W harxhon më pak energji se një llambë e thjeshtë po 60 W?
 - Rrjedhja e elektroneve, që rrjedhin nëpër llambën fluoreshente, bëhet nën një tension më të ulët, që redukton energjinë e harxhuar.
 - Rrjedhja e elektroneve, që rrjedhin nëpër llambën fluoreshente, bëhet nën një tension më të lartë, që redukton energjinë e harxhuar.
 - Llamba fluoreshente ka një rezistencë më të vogël se llamba e thjeshtë.
 - Ato përdorin të njëjtën sasi energjie.
4. Llogaritni rrymën në një qark, ku tensioni është 5V dhe rezistenca e plotë e qarkut është 5Ω?
 - 1 A
 - 2 A
 - 10 A
 - 25 A
5. Sa është rezistenca e plotë e një qarku ku diferenca potencialit është 12V dhe rryma që rrjedh në të është 3A?
 - 2 Ω
 - 3 Ω
 - 4 Ω
 - 5 Ω
6. Dy rezistenca të njëjta prej 2Ω janë të lidhura në paralel në një qark. Nëse diferenca e potencialit në qark është 10V, sa është rryma që rrjedh nëpër secilën rezistencë?

- 5 A
 - 10 A
 - 20 A
 - 40 A
7. Sa është rryma që rrjedh në një qark, në të cilin janë të lidhura tri rezistenca, në seri me një burim rryme me diferencë potenciali 12 V? (Vlerat përkatëse të rezistencave janë 3 Ω , 5 Ω dhe 7 Ω .)
- 0,8 A
 - 1 A
 - 2 A
 - 10 A
8. Nëse dy elemente janë të lidhura paralel në një qark, çfarë mund të themi për diferencën e potencialit, që zbatohet në secilin element?
- Varet se në cilin element është zbatuar tensioni.
 - Varet nga rezistenca e secilit element.
 - Një element merr dyfish më shumë tension se tjetri.
 - Janë të barabarta.
9. Cili është përkufizimi i rrymës?
- Rrjedhja e atomeve nëpër një qark
 - Rrjedhja e drejtuar e elektroneve nëpër një qark
 - Sasia e rezistencës së elektroneve që rrjedhin në një qark
 - Energjia që zotëron çdo elektron kur rrjedh nëpër një qark
10. Dy qarqe të ndryshme përmbajnë në to dy llamba. Në një nga qarqet, llambat janë të lidhura në seri, kurse në qarkun tjetër janë të lidhura në paralel. Nëse të dy qarqet kanë të njëjtën rezistencë dhe zbatohet i njëjti tension, në cilin prej tyre llambat do të ndriçojnë më shumë?
- Në qarkun me lidhje në paralel
 - Në qarkun me lidhje në seri
 - Të dyja llambat ndriçojnë njësoj
 - Është e vështirë të thuhet

Pyetjet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigjet e sakta	2	1	3	1	3	1	1	4	2	2